

THIRRJE PËR OFERTË

Pajisje teknologjike (tableta) për fëmijë të familjeve në nevojë

Projekti “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” synon të kontribuojë në përmirësimin e njohurive të të rinjve dhe pjesëmarrjen e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë së Istogut. Grupi kryesor i synuar i projektit janë fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Istogut. Ky projekt mundësohet nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD dhe financohet nga Bashkimi Evropian, me bashkë-financim nga Komuna e Istogut, dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Si rrjedhojë e situatës se krijuar nga COVID19 edhe në Kosovë, programi ReLOaD do të ofroj asistencë në forma të ndryshme për grupet e cënueshme në të gjitha komunat partnere përmes disa OSHC-ve të kontraktuara në komunat përkatëse. Andaj, disa nga fondet e projektit të OJQ EC MA NDRYSHE do të shfrytëzohen për blerjen e pajisjeve teknologjike për nxënësit e zonave rurale në Komunën e Istogut, ku mësimi online është pothuajse i pamundur për shkak të mungesës së kushteve teknologjike.

Shënim: Identifikimi i nevojave për asistencë nga programi ReLOaD në Komunën e Istogut janë bërë në konsultim dhe koordinim me komunën, duke përfshirë edhe listat e përfutuesve të asistencës.

EC Ma Ndryshe fton kompanitë e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për:

Pajisje teknologjike (tableta) për fëmijë të familjeve në nevojë me këto specifika:

Processor: 2.0 GHz Quad-Core Processor

- RAM: 2GB RAM
- Internal Storage: 32GB
- Camera Front: 2 MP
- Camera Rear: 5 MP
- Display: 8 Inch
- Display: 1280 x 800 Resolution
- Connectivity: WiFi
- Battery: 4800 mAh
- Color: Black
- Manufacturer Warranty: 1 year

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSh-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Çmimi duhet të përfshijë koston e transportit deri në zyrat e EC Ma Ndryshe,
- Çdo pajisje duhet të ketë garancion,
- Ofertat duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org ose fizikisht në zyrat e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren deri më datë 07.06.2020, ora 15:00 me shënim: Ofertë për “Pajisje teknologjike për fëmijë të familjeve në nevojë”.
- Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më datë 05.06.2020.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm kompanitë fitues do të informohen/kontaktohen. Për më shumë informacione rreth kësaj thirrjeje për aplikim, ju lutemi vizitoni www.ecmandryshe.org/konkurse.